



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Nr. 3 Prot.

Shkodër, më 10 . 07.2023

Vendim

Nr. 03 Datë 10 /07/2023

**PËR
ZMADHIMIN E KAPITALIT DHE PRANIMIN E AKSIONARIT TË RI TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A**

Në mbështetje të nenit 135 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” ndryshuar; të Statutit të Shoqërisë; të VKM Nr.302, datë 11.05.2022 “ Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”; të Marrëveshjes për Krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A, të lidhur midis Bashkive Malësi e Madhe, Vau Dejës, Pukë dhe Fushë-Arrëz dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 19.01.2023,

VENDOSI:

1. Pranimin e shlyerjes së kapitalit të nënshkruar nëpërmjet kontributit në natyrë të rezultuar nga transferimi i veprimtarive për vlerat si vijon:

Aksionari	Vlera në Lekë e kontributit të paguar në natyrë
Bashkia Fushë Arrëz	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	2,470,000
Bashkia Pukë	849,000
Bashkia Vau i Dejës	1,248,000
TOTAL	4,900,000

2. Të miratojë zmadhimin e kapitalit ligjor nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja të pagueshme në para.
3. Shoqëria do të emetojë 286,730 copë aksione të reja të zakonshme me vlerë nominale prej 100 Lekë secili, me një vlerë totale prej 28,673,000 lekë.



4. Aksionet e reja do të paguhen dhe zotërohen nga aksionarët si vijon:

Aksionari	Numri i aksioneve të reja të zakonshme të zotëruara _Copë	Vlera e kapitalit të ri të zotëruar _Lekë	Vlera aktualisht e paguar e aksioneve të reja _Lekë (e pagueshme menjëherë pas miratimit nga Asambleja)
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	146,270	14,627,000	7,500,000
Bashkia Shkodër	140,530	14,053,000	
TOTAL	286,800	28,680,000	7,500,000

5. Pas zmadhimit kapitali ligjor i shoqërisë do të bëhet 38,680,000 lekë, i përbërë nga 386.800 aksione me vlerë nominale prej 100 Lekë secili. Përbërja e aksionarëve dhe pjesëmarrja pas zmadhimit si dhe pagesa e kapitalit rezulton si vijon:

Aksionari	Numri i aksioneve të zakonshme të zotëruara _Copë	Përqindja e pjesëmarrjes në kapital	Vlera e kapitalit të zotëruar _Lekë	Vlera e kapitalit të paguar _Lekë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	197,270	51.00 %	19,727,000	12,600,000
Bashkia Shkodër	140,530	36.33%	14,053,000	0
Bashkia Fushë Arrëz	3,330	0.86%	333,000	333,000
Bashkia Malësi e Madhe	24,700	6.39%	2,470,000	2,470,000
Bashkia Pukë	8,490	2.19%	849,000	849,000
Bashkia Vau i Dejës	12,480	3.23%	1,248,000	1,248,000
TOTAL	386,800	100.00%	38,680,000	17,500,000

6. Ngarkohet shoqëria për depozitimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bashkia Pukë

Bashkia Fushë Arrëz

HIL CURRI

Bashkia Vau i Dejës

Bashkia Malësi e Madhe

Bashkia Shkodër